

**DOKUMENT I POSAÇËM IDENTIFIKIMI**



- Pranohet për të hipur në një fluturim të brendshëm ose për të hyrë në një ndërtesë federale
- Nuk ka tarifë shtesë
- Kriteret e kualifikimit: dëshmi e sigurimeve shoqërore, dëshmi e shtetësisë ose statusit të ligjshëm, 2 dëshmi të rezidencës dhe 6 pikë të dëshmisë së emrit.

**DOKUMENT IDENTIFIKIMI SPECIAL**



- Pranohet për të hipur në një fluturim të brendshëm ose për të hyrë në një ndërtesë federale
- Pranohet në pikat tokësore/detare të kalimit kufitar të SHBA-së
- I disponueshëm vetëm për shtetasit amerikanë
- Tarifë shtesë prej 30 \$
- Kriteret e kualifikimit: dëshmi e sigurimeve shoqërore, dëshmi e shtetësisë, 2 dëshmi të rezidencës dhe 6 pikë të dëshmisë së emrit.

**DOKUMENT IDENTIFIKIMI STANDARD**

JO PËR QËLLIME FEDERALE

- Nuk pranohet për të hipur në një fluturim të brendshëm ose për të hyrë në një ndërtesë federale
- Formë identifikimi që nuk njihet nga qeveria federale
- Nuk ka tarifë shtesë
- Kriteret e kualifikimit: dëshmi e datës së lindjes, 1 dëshmi e rezidencës dhe 6 pikë të dëshmisë së emrit. (Për kërkesat për CDL dhe për kartë identiteti për jodrejtuesit, shihni faqen 4)

Për më shumë informacion rreth dokumenteve të posaçme ose dokumenteve speciale të identifikimit, mund të vizitoni [dmv.ny.gov/realid](http://dmv.ny.gov/realid)

- SHËNIM:**
- Duhet të jepni dokumente **origjinale** ose dokumente që janë të certifikuara nga agjencia lëshuese.
  - Përveçse kur është përcaktuar në mënyrë specifike, DMV nuk i pranon dokumentet e skaduar.

SEKSIONI A: Duhet të jepni një (1) nga dokumentet e mëposhtme lidhur me sigurimet shoqërore. Shënoni pikët e dëshmisë së emrit për dëshminë e zgjedhur.		Dëshmi e emrit Vlera në pikë
↓	Shënoni kutinë për të identifikuar dokumentet që planifikoni të sillni në zyrën e DMV-së.	
	Kartë e sigurimit shoqëror e SHBA-së	2
	Letër e moskualifikimit për sigurime shoqërore (për më shumë informacion, shihni kërkesat në faqen 3)	0
	Deklaratë që tregon se nuk ju u është lëshuar kurrë një numër i sigurimeve shoqërore (NSS-1 ose NSS-1A) *	0
	Numri i sigurimeve shoqërore pa kartën (Numri duhet të jetë i printuar në MV-44) *	0

\* Nuk përdoret për dokumente speciale ose të posaçme

SEKSIONI B: Duhet të jepni të paktën një (1) dëshmi nga një prej kategorive të mëposhtme. Të gjitha dëshmitë në këtë seksion vlejnë si dëshmi të datës së lindjes. Shënoni pikët e dëshmisë së emrit për dëshminë e zgjedhur.		Dëshmi e emrit Vlera në pikë
↓	<b>DËSHMI TË SHTETËSISË:</b> Shënoni kutinë për të identifikuar dokumentet që planifikoni të sillni në zyrën e DMV-së.	
	Pasaportë ose kartë për pasaportë e SHBA-së	4
	Certifikatë natyralizimi ose shtetësie (N-550, N-560, N-561 dhe N-570)	3
	Certifikatë lindjeje e SHBA-së (lëshuar nga një shtet ose administratë vendore)	0
	Kopje origjinale ose e certifikuar e Raportit Konsullor të SHBA-së për lindjet jashtë vendit (FS-240, DS-1350, F-545)	0
↓	<b>DËSHMI TË STATUSIT TË LIGJSHËM:</b> Shënoni kutinë për të identifikuar dokumentet që planifikoni të sillni në zyrën e DMV-së. (Nuk përdoret për dokumente speciale)	
	Pasaportë e huaj (për më shumë informacion, shihni kërkesat për pasaportat e huaja në faqen 3)	4
	Kartë e paskaduar e rezidencës së përhershme I-551	3
	Kartë autorizimi për punësim (I-688B or I-766) me foto, e shoqëruar nga dokumentacioni i miratuar nga Departamenti i Sigurisë Kombëtare (p.sh., I-797) që konstaton në mënyrë specifike statusin e vlefshëm dhe të ligjshëm si qytetar amerikan, siç përcaktohet në titullin 6, pjesa 37.3 të Kodit të Rregulloreve Federale (6 C.F.R. 37.3)	3
	Kartë autorizimi për punësim (I-688B or I-766) me foto, e lëshuar nga Shërbimi i Emigracionit dhe Natyralizimit/Departamenti i Sigurisë Kombëtare (duhet të jetë e vlefshme) <b>(NUK PËRDORËT PËR DOKUMENTE TË POSAÇME)</b>	3
↓	<b>DËSHMI VETËM TË DATËS SË LINDJES:</b> Shënoni kutinë për të identifikuar dokumentet që planifikoni të sillni në zyrën e DMV-së. (Nuk përdoret për dokumente speciale, të posaçme, ose për kartat e identitetit për jodrejtuesit)	
	Certifikatë lindjeje e huaj (e lëshuar nga një subjekt qeveritar)	0
	Kartë e skaduar e rezidencës së përhershme (të mos ketë më shumë se 2 vite që ka skaduar)	2
	Kartë autorizimi për punësim e skaduar (I-688B or I-766) me foto, e lëshuar nga Shërbimi i Emigracionit dhe Natyralizimit/Departamenti i Sigurisë Kombëtare (të mos ketë më shumë se 2 vite që ka skaduar)	2
	Kartë identiteti fisnore me foto e St. Regis Mohawk	2
	Certifikatë lindjeje fisnore nga një fis i njohur në nivel federal që vërteton lindjen në SHBA	0
	Dokument identifikimi konsullor	4
	Leje drejtimi e huaj me foto. Duhet të jetë e vlefshme ose të mos ketë më shumë se 2 vite që ka skaduar.	4
	Kartë për kalimin e kufirit	3
	Kartë identiteti me foto e ushtrisë së SHBA-së (lëshuar vetëm për personelin ushtarak aktiv, rezervë dhe në pension)	3
	Leje drejtimi/Leje praktikanti/Kartë identiteti për jodrejtuesit, me foto, e lëshuar nga një tjetër shtet, juridiksion ose territor i SHBA-së, ose nga një provincë ose territor kanadez. Duhet të jetë e vlefshme ose të mos ketë më shumë se 2 vite që ka skaduar.	4

Mblidhni pikët e dëshmisë së emrit që keni shënuar në seksionet A dhe B

- Nëse keni të paktën 6 pikë, përdorni seksionin C për të përbushur kërkesat e rezidencës për dokumentin për të cilin po aplikoni.
- Nëse totali është më pak se 6 pikë, duhet të jepni dëshmi shtesë nga seksioni C për ta çuar totalin në 6 pikë ose më tepër. Këto dëshmi duhet të përfshijnë dëshmitë e kërkuara të rezidencës për dokumentet për të cilat po aplikoni.

**SEKSIONI C: Dëshmi e rezidencës e shtetit të Nju-Jorkut dhe dëshmi shtesë të emrit**

Duhet të jepni 2 dëshmi të rezidencës për një dokument special ose për një dokument të posaçëm, ose 1 dëshmi të rezidencës për një leje drejtimi ose leje praktikanti standarde.

↓ Adresa aktuale duhet të jetë e printuar paraprakisht në dokument në mënyrë që të përdoret si dëshmi e rezidencës (Kutia postare nuk është e pranueshme). Deklaratat elektronike dhe faturat elektronike duhet të printohen. Mund të pranohet vetëm një nga secila dëshmi. Shënoni rutinë për të identifikuar dokumentet që planifikoni të sillni në zyrën e DMV-së.	Dëshmi e rezidencës e shtetit të Nju-Jorkut	Dëshmi e emrit Vlera në pikë
Leje drejtimi/Leje praktikanti/Kartë identiteti për jodrejtesit e shtetit të Nju-Jorkut. Duhet të jetë e vlefshme ose të mos ketë më shumë se 2 vjet që ka skaduar	PO	6
Deklaratë identiteti e DMV-së dhe/ose deklaratë vendbanimi nga prindi/kujdestari (MV-45) NËSE JENI NËN MOSHËN 21 VJEÇ .	PO	4
Deklaratë identiteti e DMV-së dhe/ose deklaratë vendbanimi (MV-45A) - Për aplikantët e përfaqësuar nga qeveria ose institucionet e miratuara nga qeveria	PO	4
Deklaratë identiteti e DMV-së (MV-45B) - Për aplikantët që mund të konsiderohen si të rinj pa zotësi juridike, të pastrehë *	PO	4
Certifikatë pronësie e shtetit të Nju-Jorkut	PO	2
Licencë profesionale e shtetit të Nju-Jorkut	PO	2
Leje për armëmbajtje e shtetit të Nju-Jorkut/qytetit të Nju-Jorkut	PO	2
Kartë identiteti me foto e shkollës së mesme e SHBA-së me kartë raporti ose transkript zyrtar	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	2
Kartë identiteti me foto e kolegjit e SHBA-së dhe transkripti zyrtar	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	2
Pasqyrë e llogarisë bankare	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	1
Çek i anuluar	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	1
Mandat pagese i printuar në kompjuter i SHBA-së	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	1
Kartë identiteti me foto e bashkisë e SHBA-së	PO	1
Policë e sigurimit të jetës ose deklaratë aktuale (e vlefshme për të paktën 2 vjet)	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	1
Faturë e shërbimeve	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	1
Formulari W-2 për tatimin mbi të ardhurat në nivel federal ose në nivelin e shtetit të Nju-Jorkut	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	1
Transkript tatimor nga IRS ose letër e lëshimit të numrit individual të identifikimit të tatimpaguesit *	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	1
Deklaratë vjetore e sigurimeve shoqërore (SSA-1099)	PO (viti aktual)	1
Deklaratë e tatimit mbi të ardhurat në nivel federal ose në nivelin e shtetit të Nju-Jorkut, ose deklaratë e fitimeve (SSA-1099, SSA-1098)	PO (viti aktual)	0
Certifikatë rezidence e DMV-së (MV-44NYR) **	PO	0
Deklaratë nga një institucion për personat me aftësi të kufizuara ose shtëpi për të moshuarit	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Pasqyrë e kartës së kreditit	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Dëshmi aktuale e sigurimit të pronarëve të shtëpisë/qiramarrësve (policë sigurimi, dëshmi e kërkesës)	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Njoftim për thirrjen në detyrë si anëtar jurie në gjykatë	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Certifikatë e kontrollorit mjekësor me adresë të shtetit të Nju-Jorkut dhe me nënshkrimin përkatës (për kërkesën e kontrollit mjekësor për CDL)	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Urdhra ushtarakë që janë ende në fuqi	PO	0
Postë me pullë	PO (nëse nuk ka më shumë se një vit që është postuar)	0
Dëshmi të hipotekës aktuale	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Akt pronësie	PO	0
Fatura të taksës së pronës ose të arsimit për vitin aktual (duhet të pasqyrojnë adresën aktuale në seksionin e adresës postare dhe duhet të përmbajnë seksionin ku përcaktohet prona që po tathohet)	PO	0
Kontrata e qirasë së banesës	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Deklarata e daljes në pension	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Karta e shërbimit ushtarak	PO	0
Deklarata e dhënies së të ardhurave shtesë të sigurisë	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Deklarata e të ardhurave nga papunësia	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Karta e njoftimit të regjistrimit të votuesve	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Deklarata e përfitimeve të mirëqenies	PO (nëse nuk ka më shumë se 1 vit që është lëshuar)	0
Karta e identitetit e prindit/bashkëshortit/bashkëshortes (me të njëjtin mbiemër ose me dëshmi të marrëdhënies)	PO	0
Kartë identiteti me foto e ushtrisë së SHBA-së (lëshuar vetëm për personelin ushtarak aktiv, rezervë dhe në pension)	JO	3
Leje rihyrjeje (I-327)	JO	3
Dokument udhëtimi për refugjatët (I-571)	JO	3
Kartë e përfitimeve shëndetësore/Medicaid e shtetit të Nju-Jorkut me foto	JO	3
Leje drejtimi/Leje praktikanti/Kartë identiteti për jodrejtesit, e përkohshme, pa foto, e lëshuar nga shteti i Nju-Jorkut.	JO	2
Dokument regjistrimi i shtetit të Nju-Jorkut (vetëm për automjetet ose varkat)	JO	2
Leje drejtimi/Leje praktikanti/Kartë identiteti për jodrejtesit, me foto, e lëshuar nga një tjetër shtet, juridiksion ose territor i SHBA-së, ose nga një provincë ose territor kanadez. Duhet të jetë e vlefshme ose të mos ketë më shumë se dy vite që ka skaduar.	JO	4

**SEKSIONI C: Dëshmi e rezidencës e shtetit të Nju-Jorkut dhe dëshmi shtesë të emrit (vazhdim)**

Duhet të jepni 2 dëshmi të rezidencës për një dokument special ose për një dokument të posaçëm, ose 1 dëshmi të rezidencës për një leje drejtimi ose leje praktikanti standarde.

↓	Adresa aktuale duhet të jetë e printuar paraprakisht në dokument në mënyrë që të përdoret si dëshmi e rezidencës (Kutia postare nuk është e pranueshme). Pasqyrat elektronike dhe faturat elektronike duhet të printohen. Mund të pranohet vetëm një nga secila dëshmi. Shënoni kutinë për të identifikuar dokumentet që planifikoni të sillni në zyrën e DMV-së.	Dëshmi e rezidencës e shtetit të Nju-Jorkut	Dëshmi e emrit Vlera në pikë
	Dokument i regjistrimit të martesave ose divorceve i lëshuar nga një shtet ose administratë vendore e SHBA-së OSE vendim për ndryshimin e emrit i lëshuar nga gjykata	JO	2
	Dokument i huaj i regjistrimit të martesave ose divorceve (i lëshuar nga një subjekt qeveritar) OSE vendim për ndryshimin e emrit i lëshuar nga gjykata *	JO	2
	Kartë identiteti e vartësve ushtarakë e SHBA-së	JO	2
	Kartë e përfitimeve shëndetësore/Medicaid e shtetit të Nju-Jorkut PA foto	JO	2
	Kartë debiti (ATM) (duhet të ketë nënshkrimin dhe emrin e printuar paraprakisht)	JO	1
	Kartë krediti kryesore e vlefshme	JO	1
	Kartë identiteti e punonjësit e SHBA-së	JO	1
	Diplomë e shkollës së mesme e SHBA-së OSE GED	JO	1
	Kartë arkëtimi supermarketi e SHBA-së (duhet të ketë nënshkrimin dhe emrin e printuar paraprakisht)	JO	1
	Kartë sindikate e SHBA-së	JO	1
	Kartë identiteti me foto e Aksesit Universal të Veteranëve	JO	1
	Kartë e sigurimit shëndetësor/Kartë për receta për të dhënë dëshmi aktuale të mbulimit me sigurim shëndetësor	JO	1
	Dokument i gjykatës i SHBA-së me emrin e aplikantit si palë *	JO	1
	Dëftesë shkolle e huaj me foto *	JO	2
	Dëftesë shkolle e huaj pa foto *	JO	1

\* Nuk përdoret për një dokument special ose për një dokument të posaçëm

\*\* Nuk përdoret për një dokument standard

Mblidhni pikët e dëshmisë së emrit që keni shënuar në seksionet A, B dhe C (totali duhet të jetë të paktën 6 pikë)

**TË GJITHË APLIKANTËT DUHET:**

- Të plotësojnë aplikimin për leje praktikanti, leje drejtimi, ose kartë identiteti për jodrejtesit (formulari MV-44).
- Të paraqesin dëshmitë e kërkuara të identifikimit. Mund të vizitoni online dokumentin udhëzues të DMV-së të shtetit të Nju-Jorkut në adresën [dmv.ny.gov/DocumentGuide](http://dmv.ny.gov/DocumentGuide) OSE mund t'u referoheni tabelave në faqet 1 - 3 për dëshmitë e pranueshme.
- Aplikantët për leje drejtimi dhe leje praktikanti duhet të kalojnë testin e shikimit.
- Të paguajnë tarifën. Mund të paguani me kartë krediti, me para në dorë, ose me çek apo urdhërtransferte në emër të "Komisionerit të Mjeteve Motorike".

**KËRKESA TË PËRGJITHSHME:**

- Moskualifikimi për sigurime shoqërore (vetëm për dokumentet e posaçme):
  - Nëse nuk jeni të kualifikuar për të pasur një numër të sigurimeve shoqërore, duhet të paraqisni një letër nga Administrata e Sigurimeve Shoqërore (SSA), të lëshuar jo më parë se 30 ditë nga data e vizitës suaj në zyrë, e cila tregon se nuk jeni të kualifikuar për një numër të sigurimeve shoqërore. Gjithashtu, duhet të paraqisni dokumentacionin e Departamentit të Sigurisë Kombëtare që i është paraqitur SSA-së për të përcaktuar se nuk jeni të kualifikuar.
  - Për informacion mbi mënyrën e marrjes së një duplikate të kartës, ose për adresën e zyrës suaj vendore të SSA-së, vizitoni adresën [www.ssa.gov](http://www.ssa.gov)
- Dokumentet në gjuhë të huaj:
  - Me qëllim që të pranohen, dokumentet në gjuhë të huaj duhet të shoqërohen nga një përkthim i certifikuar në gjuhën angleze.
- Dokumentet e dëmtuara:
  - DMV nuk do të pranojë asnjë dokument të dëmtuar apo të shkatërruar, ose dokument me ndryshime apo fshirje. DMV do të konfiskoje çdo dokument që duket si i rremë. Nëse dorëzoni një dokument të rremë, mund të jeni subjekt i ndjekjes penale.
- Vetëm një dëshmi nga një burim ose lloj:
  - DMV nuk do të pranojë më tepër se një dokument nga e njëjta lloj dëshmie ose nga i njëjti burim. Për shembull, DMV do të pranojë vetëm një pasqyrë të kartës së kreditit kryesore, ose vetëm një faturë të shërbimeve, ose DMV nuk do të pranojë një pasqyrë të llogarisë bankare dhe një pasqyrë të kartës së kreditit nga i njëjti institucion financiar.

**KËRKESAT PËR DOKUMENTET SPECIALE DHE TË POSAÇME:**

- Emri i plotë ligjor:
  - Në faqen 1 të dokumentit nga seksioni B, duhet të tregoni emrin tuaj të plotë, emrin e plotë të mesëm (sipas rastit) dhe mbiemrin e plotë me prapashtesa (sipas rastit). Ky emër i plotë do të shfaqet në kartën tuaj.
    - Nëse emri juaj ka ndryshuar nga emri i paraqitur në këtë dokument, duhet të sillni kopje origjinale ose të certifikuar që dokumentojnë këtë ndryshim (certifikatë martesë, vendim divorci, dokumente të lëshuara nga gjykata). Nëse emri juaj ka ndryshuar disa herë, duhet të sillni disa dokumente që lidhin të gjitha emrat.
- Pasaportë e huaj:
  - Nëse po dorëzoni një pasaportë të huaj si dëshmi të statusit të ligjshëm, duhet të keni një nga dokumentet në vijim:
    - një vizë të vlefshme dhe një formular të vlefshëm I-94 të lëshuar nga Shërbimi i Emigracionit dhe Natyralizimit/Departamenti i Sigurisë Kombëtare, ose vulë të lëshuar nga Doganat dhe Patrulla Kufitare
    - një vulë të vlefshme I-551 - Lloji i statusit të ligjshëm i përcaktuar nga verifikimi i Departamentit të Sigurisë Kombëtare
    - një deklaratë të vlefshme I-551 për vizën - Lloji i statusit të ligjshëm i përcaktuar nga verifikimi i Departamentit të Sigurisë Kombëtare
  - Një pasaportë e huaj pa dokumentacion shoqëruar mund të përdoret si dëshmi e datës së lindjes. Ajo NUK do të pranohet si dëshmi e statusit të ligjshëm dhe nuk mund të përdoret për një dokument special ose për një dokument të posaçëm, apo për një kartë identiteti për jodrejtesit.
- Adresa aktuale në shtetin e Nju-Jorkut:
  - Çdo dokument duhet të tregojë adresën tuaj aktuale në shtetin e Nju-Jorkut.
  - Një adresë me kuti postare nuk është e pranueshme.
  - Adresa juaj aktuale do të shfaqet në dokumentin e posaçëm ose special.
- Statusi i ligjshëm i përkohshëm:
  - Nëse keni një status të ligjshëm të përkohshëm, përgatituni për të paraqitur dokumentacionin aktual.
- Opsione shtesë ndaj kartës së sigurimeve shoqërore:
  - Nëse keni një dokument të vlefshëm me foto të shtetit të Nju-Jorkut, mund të dorëzoni një nga dokumentet e mëposhtme në vend të kartës së sigurimeve shoqërore. Dokumenti duhet të përmbajë numrin e plotë të sigurimeve shoqërore. Dokumentet e mëposhtme janë të pranueshme për këtë qëllim, pavarësisht datës së lëshimit.
    - Formulari W-2 për tatimin mbi të ardhurat në nivel federal ose në nivelin e shtetit të Nju-Jorkut
    - Deklaratë vjetore e sigurimeve shoqërore (SSA-1099)
    - Deklaratë e tatimit mbi të ardhurat në nivel federal ose në nivelin e shtetit të Nju-Jorkut, ose deklaratë e fitimeve (SSA-1099)

## PËR TË APLIKUAR PËR NJË:

### Leje praktikanti - Kategoria D (Operator) ose M (Motoçikletë):

- Duhet të kaloni një provim me shkrim dhe testin e shikimit. Manuali për drejtuesit e mjetit dhe provimet për t'u praktikuar janë të disponueshme në faqen tonë të internetit [dmv.ny.gov](http://dmv.ny.gov)
- Duhet të jeni të paktën 16 vjeç për të aplikuar për një leje praktikanti ose leje drejtimi. Duhet të merrni pëlqimin e prindërve nëse jeni 16 ose 17 vjeç, përveçse kur jeni 17 vjeç dhe zotëroni një Certifikatë të përfundimit të formimit të drejtuesve (formulari MV-285).
- Drejtuesit e rinj marrin një leje praktikanti që mund të jetë e vlefshme për më tepër se një vit. Nëse keni një status të ligjshëm të përkohshëm dhe po aplikoni për një dokument të posaçëm identifikimi, do të merrni një dokument që skadon jo më vonë se data e skadimit në dokumentin e statusit të ligjshëm të përkohshëm.

### Kartë identiteti për jodrejtuesit:

- Duhet të jepni dëshmi të shtetësisë ose statusit të ligjshëm.
- Për një dokument standard nuk nevojitet dëshmia e rezidencës.
- Nuk ka kufizim moshe për të marrë një kartë identiteti për jodrejtuesit. Megjithatë, nëse jeni nën 16 vjeç, nevojitet pëlqimi i prindërve.
- Nëse jeni përfytyes të të ardhurave shtesë të sigurisë (SSI), merrni me vete dokumentacionin përkatës në zyrë.

### Leje drejtimi të shtetit të Nju-Jorkut duke transferuar një leje të lëshuar nga jashtë shtetit:

- Kërkesa për provimin e shkruar dhe të praktikës mund të hiqet nëse zotëroni një leje drejtimi të lëshuar nga një tjetër shtet i SHBA-së, juridiksion i SHBA-së, provincë kanadeze, apo territor kanadez, e cila ka qenë në fuqi për 6 muaj dhe nuk ka më shumë se 2 vite që ka skaduar.
- Nëse data e lëshimit në lejen tuaj të drejtimit është brenda 6 muajve të fundit, duhet të merrni një kopje të certifikuar të precedentëve të drejtimit për të treguar se e keni pasur lejen për më tepër se 6 muaj.
- Shteti i Nju-Jorkut do t'ju mbajë lejen e drejtimit të lëshuar nga jashtë shtetit.
- Nëse jeni nën 18 vjeç, nevojitet pëlqimi i prindërve.

## PËR TË RINOVUAR NJË:

### Leje praktikanti - Kategoria D (Operator) ose M (Motoçikletë):

- Duhet të keni kaluar një provim me shkrim brenda 2 viteve të fundit.

### Leje drejtimi:

- Duhet të kaloni testin e shikimit. Nëse e keni kaluar testin e shikimit në një ofrues të autorizuar të regjistrimit të testeve të shikimit, mund ta rinovoni lejen e drejtimit online në adresën [dmv.ny.gov](http://dmv.ny.gov)

### Kartë identiteti për jodrejtuesit:

- Mund ta rinovoni kartën e identitetit për jodrejtuesit online në adresën [dmv.ny.gov](http://dmv.ny.gov)

## PËR TË KALUAR:

### Një leje DJ ose MJ në një leje D ose M:

- Nëse jeni 17 vjeç, sillni Certifikatën e përfundimit të formimit të drejtuesve (formulari MV-285). Nëse jeni 18 vjeç, nuk është e nevojshme që të vini në një zyrë, pasi dokumenti do t'ju dërgohet automatikisht me postë.

### Në një leje drejtimi të një kategorie më të lartë ose për të shtuar një kategori të lejes së drejtimit:

- Për të kaluar në një leje drejtimi të kategorisë E duhet të paguani një tarifë shtesë për lejen.
- Për të marrë një leje drejtimi të kategorisë A, B, ose C duhet të kaloni provimin me shkrim të njohurive të përgjithshme të CDL-së, si dhe mund t'ju kërkohet që të kaloni një provim me shkrim të miratimit të CDL-së. Lejet e drejtimit të kategorisë A dhe B kërkojnë gjithashtu një leje praktikanti dhe kalimin e provimit të aftësive. Duhet të vërtetoni statusin e ligjshëm dhe të jepni dëshmi të rezidencës në shtetin e Nju-Jorkut.
- Mund të dorëzoni një kartë autorizimi për punësim (I-688B ose I-766) si dëshmi të statusit të ligjshëm në rastet kur aplikoni për një leje drejtimi tregtare standarde.
- Nëse aplikoni për një miratim për automjet për ferma (F ose G), ose për një miratim për kamion me rimorkio (W), do t'ju lëshohet një leje drejtimi e kategorisë C.
- Mund të dorëzoni një ftesë për rinovimin e një dokumenti me foto të shtetit të Nju-Jorkut (MV-2) si dëshmi të rezidencës në rastet kur aplikoni për një leje drejtimi tregtare standarde.

## PËR TË NDRYSHUAR:

### Emrin në dokumentin ekzistues me foto të shtetit të Nju-Jorkut:

- Duhet të paraqisni një certifikatë martesë origjinale të SHBA-së, ose një dokument të regjistrimit të divorcit të SHBA-së apo një kopje të certifikuar të vendimit të lëshuar të gjykatës për ndryshimin e emrit tuaj në emrin përkatës të ri.

### Një element tjetër në dokumentin tuaj ekzistues me foto të shtetit të Nju-Jorkut:

- Për opsionet e tjera të ndryshimit mund të vizitoni adresën <https://dmv.ny.gov/amend>

## PËR TË ZËVENDËSUAR NJË:

### Dokument me foto të humbur, të dëmtuar ose të vjedhur të shtetit të Nju-Jorkut:

- DMV rekomandon që të raportoni dokumentet e vjedhura pranë agjencisë vendore të zbatimit të ligjit përpara se të aplikoni për një dokument zëvendësues. Nëse i keni raportuar dokumentet e vjedhura në polici përpara se të vizitoni zyrën, sigurohuni që të sillni një kopje të dokumentit të raportimit në polici.

LLOJI I TRANSAKSIONIT	Totali nuk do të jetë më tepër se
Të gjitha vlerat e tarifave janë të përafërta. Tarifa e saktë nuk mund të përcaktohet derisa të lëshohet dokumenti.	
Leje praktikanti (Kategoria DJ/D ose MJ/M)	136,00 \$
Leje drejtimi (Kategoria D ose M)	98,50 \$
Leje drejtimi (CDL ose kategoria E)	180,50 \$
Kartë identiteti për jodrejtuesit	13,00 \$
Kartë identiteti për jodrejtuesit [Përfytyes i të ardhurave shtesë të sigurisë (SSI)]	6,50 \$
Kalim në një leje drejtimi të kategorisë më të lartë (CDL ose kategoria E)	153,00 \$*
Zëvendësim i lejes së drejtimit/lejes së praktikantit	17,50 \$
Zëvendësim i kartës së identitetit për jodrejtuesit	8,00 \$
Zëvendësim i kartës së identitetit për jodrejtuesit [Përfytyes i të ardhurave shtesë të sigurisë (SSI)]	6,50 \$
Ndryshim i lejes së drejtimit/lejes së praktikantit	17,50 \$
Ndryshim i kartës së identitetit për jodrejtuesit	5,00 \$
<b>SHËNIM:</b> Tarifë shtesë 30 \$ për transaksionet për dokumentet speciale përveçse për dokumentet zëvendësuese.	

\* Mund të aplikohen tarifa shtesë për provimin me shkrim dhe të praktikës.